



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË,  
BASHKIA DELVINË, PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VËREN:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 113, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për Këshillin e Bashkisë Delvinë. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ nuk rezulton të jetë bërë ankim.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për Këshillin e Bashkisë Delvinë për subjektet zgjedhore është si tabela nr. 1 më poshtë.

(Tabela 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Perqindja
1	Bashkë Fitojmë	804	16,47 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2025	41,47 %
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	128	2,62 %

Data: . . 2023 Nr:  
Ora:



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Delvinë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

4	Partia Republikane Shqiptare	95	1,95 %
5	Partia Levizja e Legalitetit	172	3,52 %
8	Partia Socialdemokrate	753	15,42 %
9	Partia Demokratike	416	8,52 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	245	5,02 %
13	Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë	245	5,02 %
	<b>Totali</b>	<b>4883</b>	<b>100 %</b>

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Delvinë, në bazë të shkresës nr.211/1 Prot, datë 27.02.2023, të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Herësit e përfitur nga ky pjesëtim janë në tabelën nr 2 bashkëlidhur.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfitur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin si në tabelën nr.3, më poshtë.

(Tabela 3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	2025	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1012	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	804	Bashkë Fitojmë
4	753	Partia Socialdemokrate
5	675	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	506	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	416	Partia Demokratike
8	405	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	402	Bashkë Fitojmë
10	376	Partia Socialdemokrate
11	337	Partia Socialiste e Shqipërisë
12	289	Partia Socialiste e Shqipërisë
13	268	Bashkë Fitojmë
14	253	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	251	Partia Socialdemokrate

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve si në tabelën nr.4, më poshtë.

(Tabela 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	3
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	8
3	Partia Socialdemokrate	3
4	Partia Demokratike	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Delvinë, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	3
Partia Socialiste e Shqipërisë	8
Partia Socialdemokrate	3
Partia Demokratike	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Delvinë, si më poshtë:

#### Bashkë Fitojmë

1	Anila	Sami	Kondi
2	Besnik	Shozo	Zero

Data: . . 2023 Nr:  
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Delvinë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3 Eleni Panajot Papapano

**Partia Socialiste e Shqipërisë**

1 Paola Lulëzim Boçi  
2 Fisnik Bilal Kohila  
3 Rozarta Subhi Gjikhthima  
4 Skerdian Robert Mehmeti  
5 Erinda Bujar Seitaj  
6 Petrit Selman Meleqi  
7 Suela Miltjadh Zoto  
8 Vasil Pavlo Marga

**Partia Socialdemokrate**

1 Luan Hysen Selimi  
2 Lindita Shuquri Hamiti  
3 Orgest Dashmir Basho

**Partia Demokratike**

1 Hari Kristaq Imeri

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: . . 2023 Nr:  
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Delvinë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”